



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË**

Nr. 835 prot.

Tiranë, më 27.03.2024

NJOFTIM ME SHPALLJE

TË VENDIMIT NR. 80/7, DATË 01.11.2023 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, “PËR ARKIVIMIN PAS VERIFIKIMIT TË ANKESËS SË PARAQITUR NGA SHTETASJA ZNJ. KRISTINA GJOKA”

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur të znj. Kristina Gjoka me nr. 941 prot., datë 17.02.2021, në të cilën ngrihen pretendime ndaj veprimtarisë gjyqësore të magjistratëve M.SH dhe A.A, me detyrë gjyqtarë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, në kohën e kryerjes së shkeljes së pretenduar dhe me vendimin nr. 80/7, datë 01.11.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për arkivimin pas verifikimit të ankesës së paraqitur nga shtetasja znj. Kristina Gjoka”, bazuar në nenin 117 dhe 122, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendimi duhet t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Kurbin, sipas adresës së lënë nga ankuesi; Lagjja nr. 4, Pall.123, Kodi 4701, Laç;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al.

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Konceptoi: Z. Feçi
Pranoi/Miratoi: E.Kuçi
2 (dy) kopje, datë 26.03.2024

